



Prishtinë, 14 prill 2011
Kodi i ZRRE-së: V_361_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 dhe 2.16, Nenin 25 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 03/L-185;
- Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve);
- Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike; dhe
- Aplikacionin e KEK sh.a. për të Hyra të Lejuara dhe tarifa
- Aplikacionin e KOSTT sh.a. për të Hyra të Lejuara dhe ngarkesa

Në mbledhjen e mbajtur me datë 14 prill 2011 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHEN tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, që do të zbatohen nga KEK-SH.A. nga data 01 prill 2011.

Arsyetim

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 28 shkurt 2011 nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A) ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- II. Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e lëshuara dhe të publikuara në ueb faqen e saj:
 - Shqyrtimi i pestë i tarifave të energjisë elektrike 2011 (SHTE5) – Raport konsultativ, lëshuar më 22 shkurt 2011; dhe
 - Shqyrtimi i pestë i tarifave të energjisë elektrike 2011 (SHTE5) – Shqyrtimi i komenteve, përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së, lëshuar më 14 prill 2011.
- III. Duke marr parasysh dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuar në hyrje dhe shqyrtimet të të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar të KEK-SH.A., që do të zbatohen nga data 1 prill 2011, është si në tabelën e mëposhtme



| Grupi Tarifor | Niveli i tensionit të furnizimit | Elementi Tarifor | Njësia | Koha gjatë ditës | Të miratuara | |
|---------------------------------|---|------------------------------------|-------------------|------------------|-------------------|----------------------|
| | | | | | Sezoni i Lartë | Sezoni i ulët |
| | | | | | 1 tetor - 31 mars | 1 prill - 31 shtator |
| 0-1 | 220kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 167.67 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW/muaj | | 13.26 | |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | | 2.05 | |
| 0-2 | 110kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 83.83 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW/muaj | | 5.59 | 5.59 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 6.49 | 1.92 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 2.70 | 1.58 |
| Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.00 | 0.00 | | |
| 1 | 35kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 11.08 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW/muaj | | 5.81 | 5.81 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 6.79 | 2.94 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 3.59 | 2.65 |
| Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.66 | 0.66 | | |
| 2 | 10kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 4.58 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW/muaj | | 5.01 | 5.01 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 7.61 | 3.39 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 4.10 | 3.09 |
| Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.66 | 0.66 | | |
| 3 | 0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.58 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW/muaj | | 2.91 | 2.91 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 8.45 | 4.69 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 5.33 | 4.43 |
| Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.66 | 0.66 | | |
| 4 | 0.4kV Kategoria II | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.92 | |
| | | Energjia aktive (P) | €/kWh | Tarifë e vetme | 10.41 | 6.73 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 12.53 | 8.21 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 6.26 | 4.10 |
| 5 | 0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.08 | |
| | | Energjia aktive (P) për konsum: | | | | |
| | | <200kWh/muaj (Blloku i parë): | €/kWh | Tarifë e Lartë | 4.64 | 3.33 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 2.33 | 1.66 |
| | | 200-600kWh/muaj (Blloku i dytë): | €/kWh | Tarifë e Lartë | 6.43 | 4.60 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 3.22 | 2.31 |
| | | >600 kWh/muaj (Blloku i Tretë): | €/kWh | Tarifë e Lartë | 9.33 | 6.68 |
| €/kWh | Tarifë e Ulët | | 4.66 | 3.35 | | |
| 6 | 0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.08 | |
| | | Energjia aktive (P) për konsum: | | | | |
| | | <200kWh/muaj (Blloku i parë): | €/kWh | Tarifë e vetme | 4.14 | 2.96 |
| | | 200-600kWh/muaj (Blloku i dytë): | €/kWh | Tarifë e vetme | 5.73 | 4.10 |
| >600 kWh/muaj (Blloku i Tretë): | €/kWh | Tarifë e vetme | 8.31 | 5.96 | | |
| 7 | 0.4kV (shtëpiak pa matës) | Konsumi i vlerësuar: | | | | |
| | | <200 kWh/muaj | €/konsumator/muaj | | 21.50 | |
| | | 200-600 kWh/muaj | €/konsumator/muaj | | 38.92 | |
| >600 kWh/muaj | €/konsumator/muaj | | 65.58 | | | |
| 8 | Ndriçim publik | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.92 | |
| | | Energjia aktive (P) për konsum: | €/kWh | Tarifë e vetme | 8.42 | 8.42 |

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$

- V. KEK SH.A. duhet ta publikojë këtë vendim në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë, brenda 5 ditësh të punës pas marrjes së vendimit nga ZRRE dhe publikimit të tij në faqen elektronike të saj.



- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhje në mes të përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar